



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:115960  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05637056

KPPP.nr.1648/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Beni Dona Plast Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me adresë Lagjia “Ulpiana” Rr. “Imzot Prela” pn, me NUI: 810545981, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Samir Morina me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit FC Prishtina, me adresë Rr. “Fehmi Agani”, me NUI: 810518607, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.380/22 të datës 29.04.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datën 19.04.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. HUDHET SI I PA AFAT prapësimi i debitorit FC Prishtina, ndërsa Urdhri P.nr.380/22 i datës 29.04.2022, i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Beni Dona Plast Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.380/22 të datës 29.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin

në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave dhe atë: faturës nr.005/19 të datës 30.04.2019, dhe faturës nr.006/19 të datës 30.04.2019, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën totale prej 544.40 Euro, me kamatëvonesë prej 8%, duke e llogaritur nga data kur debitori është faturuar/e ka pranuar faturën e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përmbartimor të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatës, debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.380/22 të datës 29.04.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, e ka pranuar me datë 13.05.2022, e cila vërtetohet nga pohimi i debitorit i paraqitur në prapësim, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është dorëzuar me datën 21.05.2022, e cila vërtetohet nga vula e postës së rregullt që gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme”*.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.380/22 të datës 29.04.2022, e ka pranuar me datën 13.05.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 14.05.2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 20.05.2022, por debitori prapësimin e ka dorëzuar në postë me datën 21.05.2022, dhe nga kjo rezulton se prapësimi është dorëzuar 1 (një) ditë me vonesë.

Rrjedhimisht, meqenëse është konstatuar pasafatshmëria, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga debitori dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1648/23, me datë 19.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.